

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**

Gjykata Supreme e Kosovës, në panelin e përbërë nga gjykatësit ndërkombëtar Anti Ruotsalainen, kryesues i panelit dhe gjyqtar raportues, anëtarët Renate Winter dhe Guz Van Craen dhe procesmbajtësja Alltëne Murseli në rastin penal kundër të akuzuarit Milos Jokic nga Vitia i akuzuar për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile sipas nenit 142 të LPJ, duke vendosur sipas ankesës së Branko Stanic, Zivojin Jokanovic dhe Stoja Djuricic, avokatët mbrojtës të të akuzuarit, të parashtruar kundër aktgjyqimit P.no 27/2000 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të datës 20.09.2000 në seancën e panelit të mbajtur sipas nenit 371 të LPP, me 26.04.2001 mori këtë

**VENDIM**

Ankesat e avokatëve mbrojtës të Milos Jokic, Branko Stanic, Zivojin Jokanovic dhe Stoja Djuricic, aprovohen dhe aktgjykimi P.no 27/2000 i datës 20.09.2000, i Gjykatës së Qarkut në Gjilan prishet dhe rasti i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

**ARSYETIMI**

Gjykata e Qarkut në Gjilan me aktgjykimin e saj P. no 27/2000 i datës 20.09.2000 ka gjetur Milos Jokic fajtor për krime të luftës kundër popullatës civile sipas nenit 142 të LPJ dhe e ka dënuar me njëzet (20) vjet burgim përfshirë kohën e kaluar në paraburgim prej 26.08.1999.

Ankesa të ndara ishin parashtruar kundër aktgjyqimit të gjykatës së parë nga avokatët mbrojtës Branko Stanic, Zivojin Jokanovic dhe Stoja Djuricic mbi baza të shkeljes së theksuar të dispozitave të ligjit mbi procedurën penale, shkeljeve të theksuara të dispozitave të ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i atakuar duhet të revidohet, akuzat kundër të akuzuarit të hidhen poshtë apo aktgjykimi të prishet dhe rasti të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Prokurori publik i Kosovës përmes mocionit PPA Nr. 1/2001 të datës 20 mars 2001 ka propozuar që ankesa e avokatëve mbrojtës të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. no 27/2000 të datës 18.09.2000 të vërtetohet.

Gjykata Supreme ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe ka ekzaminuar aktgjykimin e atakuar sipas nenin 376, paragrafi 1 i LPP dhe ka vlerësuar pretendimin e ankesës de gjeti i në vijim:

Ankesat e avokatëve mbrojtës të Milos Jokic janë të bazuara.

Avokati mbrojtës Branko Stanic në ankesën e tij ka referuar në[ nenin 347 të LPP i cili kërkon që gjykata të vlerësoj individualisht se a ishin provuar faktet. Nuk mjafton të referohet në deklaratat e dëshmitarëve të hëna në gjykimin kryesor. Aktgjykimi nuk përmban faktet qenësore për dënim. Deklaratat e dëshmitarëve në mënyrë të pamjaftueshme mbështesin akuzat penale. Gjykata ka refuzuar të dëgjoj dëshmitarët e përmendur nga mbrojtja. Si plotësim, 34 njerëz të cilët ende jetojnë në Viti dhe të cilët kanë nënshkruar mocionin përkitazi me personalitetin e të akuzuarit mund të kenë informacione esenciale mbi lokacionin dhe kushtet jetësore të të akuzuarit. Prezenca e Milos Jokic në Vërban me 30 maj 1999 ishte kontestuar nga S [REDACTED] D [REDACTED] S [REDACTED] P [REDACTED], Zi [REDACTED] D [REDACTED], M [REDACTED] D [REDACTED] dhe S [REDACTED] D [REDACTED]. Këta njerëz kanë dhënë deklaratat e tyre në hetime por nuk ishin dëgjuar asnjëherë në gjykimin kryesor. Gjykata nuk përmend në aktgjykim se cilat nga faktet ishin provuar dhe cilat kishin mbetur pa u vërtetuar e madje nuk kishte marrë në parasysh deklaratat e dëshmitarëve Serb të sipërpërmendur.

Shkaku se përse kishte refuzuar të pranoj propozimin individual të palëve përkitazi me prezantimin e provave mund të çoj kah anulimi i aktgjykimit *ex officio*.

Vendimi për më tepër përjashtoi shpjegimin e kryerjes së veprës penale në bashkë-veprim. Do të kishte qenë e logjikshme të gjykohen rastet e Bozidar Stanojevic dhe Agim Ajeti së bashku me atë të Milos Jokic duke supouar se këta të dy ishin bashkë-kryes. Avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic në ankesën e tij vërejt se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe kontradiktor. Pika 1 i referohet një grupi njerëzish e pikat në vijim kanë të bëjnë vetëm me të akuzuarin. Asnjë vlerësim nuk është bërë në relacion me besueshmërinë e deklaratave kontradiktore të dëshmitarëve. Në pajtim me Ligjin e procedurës krahasimi i provave duhet të përfshihet në arsyetim. Nuk mjafton vetëm të citohen dëshmitarët e caktuar. Është një rast tjetër penal ku Bozidar Stojanovic e Agim Ajeti janë gjetur fajtor për vrasjen mizore të R [REDACTED] B [REDACTED]. Andaj, nën këto rrethana, Milos Jokic nuk mund të akuzohet për të njëjtën vepër. Nuk ka prova se Milos Jokic është përfshirë në gjuajtjen dhe deportimin e Shqiptarëve. Shkaku pse dëshmitarët e përmendur nuk ishin pranuar për tu dëgjuar nuk ishte shpjeguar.

Avokati mbrojtës Stoja Djuricic në ankesën e saj i referohet letrës zyrtare të Njositit të hetimeve penale të UNMIKOut duke theksuar se gjykatësi hetues nuk ka lejuar të hetohet pjesëmarrja e Milos Jokic në rastin penal të vrasjes së R [REDACTED] B [REDACTED]. Dëshmitarët e dëgjuar nga gjykata e shkallës së parë kanë dhënë deklarata jo-konsistente gjatë gjykimit kryesor. Sipas mendjes së shëndoshë nuk është e mundur të njihet një person në unfirmë që kap viktimën për flokësh dhe e godet atë, nga distanca prej 70 metrash, siç ka thënë M [REDACTED] E [REDACTED].

Pas vlerësimit të të gjitha pretendimeve nga ankesa, Gjykata Supreme gjen se gjendja faktike ishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë, gjykata e shkallës së parë nuk ka aplikuar në mënyrë të duhur dispozitat e ligjit penal dhe andaj ka dështuar të vërtetoj faktet e rëndësishme dhe rrethanat tjera, gjatë vendosjes se të gjitha elementet e veprës penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile nga neni 142 i LPJ, janë prezente dhe i akuzuari është përgjegjës për veprën penale në fjalë.

Gjykata Supreme gjeti se ka ka prova të tjera të cilat në mënyrë të theksuar mund të influencojnë rezultatit e gjykimit në këtë rast. Andaj, gjen se është e domosdoshme që të plotësohen provat ekzistuese me provat tjera në dispozicion të cilat mund të kontribuojnë në sqarimin e incidentit.

Gjykata Supreme udhëzon gjykatën e shkallës së parë për të ri-ekzaminuar dëshmitarët S ■■■■ D ■■■■ S ■■■■ P ■■■■ Z ■■■■ D ■■■■, M ■■■■ D ■■■■ dhe S ■■■■ D ■■■■ mbi vend-ndodhjen e të pandehurit gjatë kohës kritike.

Andaj, në pajtim me dispozitat e nenit 385 të LPP, Gjykata Supreme e kthen lëndën te Gjykata qkut në Gjilan me udhëzim për të fituar provat adekuate të veprës penale. Pas mbledhjes së këtij informacioni shtesë gjykata do të vendosë mbi provat dhe fajësinë e të akzuarit, duke krahasuar peshën e provave të mbledhura.

Bazuar në të përmendurat më sipër, dhe siç parashihet me nenin 197 të LPP të aplikuar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paraburgimi i të akzuarit Milos Jokic që filloi me 1 shtator 1999 vazhdohet deri sa gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj të vendosë mbi paraburgimin.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Allten Murseli  
Procesmbajtëse

Antti Ruotsalainen  
Kryesuesi i panelit

(nënshkrimi dhe vula)